

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Prill, 2007 Nr. 16



Deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën për Planin e Ahtisarit për Statusin e Kosovës

Mbështetet finalizimi i procesit të lirisë dhe pavarësisë

Presidenti Ahtisari në plotëni ka argumentuar qëndrimin e tij të shprehur në këtë dokument të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës dhe si i tillë bashkë me pjesën e rekomandimeve politike parasheh pavarësinë e Kosovës, me një mbikëqyrje ndërkombëtare dhe një prezencë civile ndërkombëtare me trupat e NATO-s për një periudhë të ardhshme

KRYEPARLAMENTARI BERISHA PRITI
ZËVENDËSSHEFIN E UNMIK-ut, STIVEN SHUK

Kuvendi i Kosovës do të punojë edhe në dy ndërresa

Nevojitet një koordinim edhe më i madh mes Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, për përshpejtimin e procedurave për ligjet që janë paraparë në Pakon e presidentit Ahtisari



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, priti sot në një takim të rregullt pune zëvendësshefin e UNMIK-ut, Stiven Shuk, me të cilin bisedoi për proceset aktuale politike nëpër të cilat po kalon Kosova pas bërjes publike në Kombet e Bashkuara të propozimit të presidentit Marti Ahtisari për pavarësi të mbikëqyruar të Kosovës dhe pas mbështetjes që iu dha këtij propozimi nga SHBA-ja, nga Grupi i Kontaktit, nga NATO-ja, nga BE-ja dhe nga shtetet vendimmarrëse e nga mekanizma të ndryshëm evropërendimorë.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se procesi për Kosovën po ecën mirë, ndërsa një pjesë e bisedës mes zëvendësshefit të UNMIK-ut dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës u përqendrua edhe në ligjet që duhet të aprovohen sivej Kuvendi i Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha e siguroi z. Shuk se Kuvendi i Kosovës, nëse është nevoja, do të punojë edhe në dy ndërresa, në mënyrë që çdo projektligj që vjen nga Qeveria e Kosovës të kalojë menjëherë procedurat e domosdoshme në Kuvend. Gjithashtu, u tha se nevojitet një koordinim edhe më i madh mes Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, për përshpejtimin e procedurave për ligjet që janë paraparë në Pakon e presidentit Ahtisari.



PËRMBAJTJA:

Sa më shpejt të njihet pavarësia e Kosovës 8

**“Përcillja popullit të Kosovës bekimin dhe angazhimin tim”,
porositi Papa kryeparlamentarin Berisha 11**

**Për një dinamikë më të mirë të procedimit të
projektligjeve pas leximit të parë 13**

**Themelohet njësi moderne dhe funksionale e Arkivit të
Kuvendit të Kosovës 14**

Agjenda evropiane është prioritet i institucioneve të Kosovës 15

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Mbështetet finalizimi i procesit të lirisë dhe pavarësisë

- *Presidenti Ahtisari në plotëni ka argumentuar qëndrimin e tij të shprehur në këtë dokument të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës dhe si i tillë bashkë me pjesën e rekomandimeve politike parasheh pavarësinë e Kosovës, me një mbikëqyrje ndërkombëtare dhe një prezencë civile ndërkombëtare me trupat e NATO-s për një periudhë të ardhshme*
- *T'i dërgojmë botës një porosi të qartë për përkrahjen e planit të z. Ahtisari dhe falënderimin për punën e tij të madhe, si dhe për të gjithë ata që e përkrahin çështjen tonë*



Më 5 prill të këtij viti në një atmosferë solemne deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën për Planin e Ahtisarit për Statusin e Kosovës . Në rëndin e ditës së kësaj seance ishin : fjala e hapjes e kryetar-

it të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, fjala e presidentit Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjerë të Grupit të Unitetit dhe Miratimi i Deklaratës së Kuvendit. Në seancë merrnin pjesë 101 deputetë.

Fillimi i fundit të njëres ndër epokat më të errëta në historinë e Kosovës dhe të popullit të saj

Në fillim të seancës të pranishmëve iu drejtua kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, i cili pasi

përshëndeti presidentin e Kosovës dhe njëherësh kryetar i Ekipit të Unitetit, z. Fatmir Sejdiu, kryeministrin dhe anëtarët tjerë të Ekipit të Unitetit përkatësisht Agim Çekun, z. Hashim Thaçin dhe z. Veton Surroin, ministrat, zëvendësministrat dhe deputetët tha: "Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka nisur procesin e diskutimit për statusin e Kosovës. I Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara z. Ahtisari më 3 prill paraqiti dhe argumentoi raportin e tij për Kosovën. Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për Kosovën. Përdje, për herë të parë, në organin më të lartë të Kombeve të Bashkuara, në formë zyrtare u dëgjua fjala e presidentit të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu.



Me përkrahjen që iu dha pakos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Bashkimi Evropian, nga pjesë të tjera të botës dhe nga vetë Sekretari i Përgjithshëm, z. Ban Ki Mun, jo vetëm që i jepet fund një procesi mjaft të rëndë dhe të mundimshëm të bisedimeve mbi 14 muajshe për statusin e Kosovës, jo vetëm që këputen shpresat e atyre që ende ëndërrojnë në mundësitë e riciklimit të atyre bisedimeve, por edhe u shënua fillimi i fundit të njëjës ndër epokat më të errëta në historinë e Kosovës dhe të popullit të saj. Kjo nënkupton fundin e robërisë dhe fillimin e realizimit të sigurt dhe shumë të shpejtë të aspiratave krejtësisht ligjore të këtij populli për të jetuar i lirë dhe sovran në trojet e veta. Secili prej nesh, tashmë jemi prononcuar për rëndësinë e këtij momenti, pra për fillimin e bisedimeve në Këshillin e Sigurimit

lidhur me statusin e Kosovës. Sot jemi mbledhur të deklarohemi edhe si Kuvend lidhur me këtë fazë të procesit, siç kemi qenë vazhdimisht bashkë me Grupin e Unitetit gjatë këtyre muajve të bisedimeve e jemi edhe sot kësh-tu. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, jemi tubuar sot këtu në këtë seancë plenare që përmes miratimit, besoj unanimit të një deklarate nga kjo sallë t'i dërgojmë botës një porosi të qartë për përkrahjen e planit të z. Ahtisari dhe falënderimin për punën e tij të madhe, si dhe për të gjithë ata që e përkrahin çështjen tonë. Mirëpo, para se ta lexojmë para jush tekstin e Deklaratës, të hartuar dhe të pranuar nga Ekipi i Unitetit dhe Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe nga shefat e grupeve parlamentare, ftoj Presidentin e Kosovës z. Fatmir Sejdiun që ta marrë fjalën".

Kompromis për hir të së ardhmes së Kosovës

Presidenti Fatmir Sejdiu, të pranishmëve iu drejtuar me këto fjalë: I nderuari z. kryetar i Kuvendit, anëtarë të



Kryesisë së Kuvendit, anëtarë të Ekipit të Unitetit, kryeministër, ministra të nderuar dhe ju deputetë.

Më lejoni që me pak fjalë t'ju drejtohem me një informacion të shkurtër lidhur me zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë me seancën, përkatësisht çështjen e statusit politik të Kosovës, duke pasur parasysh seancën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe adresimin në këtë seancë për atë që

është bërë nga ana e presidentit Ahtisari.

Siç jeni në dijeni pakoja e përgjithshme e presidentit Ahtisari e dorëzuar ditë më herët bashkë me dokumentin e rekomandimeve u është dhënë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit më 26 mars 2007 dhe në proces normal të kapërcimit të procedurave lidhur me këtë pako presidenti Ahtisari më 3 prill, pra, para dy ditësh, ka paraqitur ekspozën e tij.

Mund të them para jush, ashtu siç besoj se keni informacione të plota se presidenti Ahtisari në plotëni ka argumentuar qëndrimin e tij të shprehur në këtë dokument të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës dhe si i tillë bashkë me pjesën e rekomandimeve politike parasheh pavarësinë e Kosovës, me një mbikëqyrje ndërkombëtare dhe një prezencë civile ndërkombëtare me trupat e NATO-s për një periudhë të ardhshme. Në këtë takim të rëndësishëm të Këshillit të Sigurimit natyrisht se është prezantuar edhe një fjalë imja, e cila është transmetuar para anëtarëve të Këshillit të Sigurimit përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, z. Ryker, sikur që është dhënë edhe një diskutim i kryeministrit të Serbisë. Ajo që mund të them është se në këtë proces të rëndësishëm fillon procedimi i konkretizuar në pjesën e të gjitha procedurave të tjera të nevojshme për të ecur në drejtim të një vendimi konkret që duhet të marrë Këshilli i Sigurimit në mbështetje të këtij dokumenti të rëndësishëm.

Ne si Kosovë duke pasur parasysh gatishmërinë tonë, punën tonë dhe të gjithë vizionin që e kemi parashtruar gjatë bisedimeve të Vjenës, duke u përmblyllur ato më 10 mars 2007,

po kështu i kemi dhënë mbështetje këtij procesi, u kemi dhënë mbështetje qëndrimeve të shprehura në pakon e përgjithshme të presidentit Ahtisari edhe dokumentit të rekomandimeve, duke konsideruar si një dokument të balancuar, duke konsideruar si një dokument në të cilin kemi bërë kompromiset tona për hir të së ardhmes së Kosovës, për hir të së ardhmes së gjithë qytetarëve të saj, prandaj të nderuar deputetë do të ishte shumë e rëndësishme që në ditën e sotme Kuvendi i Kosovës të miratojë një dokument të ri, një deklaratë me të cilën mirëpret në tërësi raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për Statusin e Kosovës z. Ahtisari, të paraqitur, po ashtu, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dokumentin e rekomandimeve se po ashtu do të jemi palë serioze në implementimin e tërësishëm të këtij dokumenti dhe të Rezolutës së supozuar që do të jetë , besoj, mbështetje e përgjithshme e vullnetit të popullit Kosovës dhe se do të presin dhe mirëpresin pa rezervë prezencën e re civile ndërkombëtare në Kosovë. Ne kemi bashkëpunuar si Grup i Unitetit me Kryesinë e Kuvendit, me shefat e grupeve parlamentare dhe se do të kemi një ide të përbashkët që Kuvendi vërtet të dalë me një tekst, me një deklaratë të përbashkët, unanime nga ky organ më i lartë përfaqësues i vendit për të mbështetur këtë proces të rëndësishëm që hap rrugën e mëtejme të procedimit edhe më të shpejtë edhe nga ana jonë dhe shpreh gatishmërinë tonë të bashkëpunimit në proceset e ardhshme për finalizimin e këtij procesi të madh që ka të bëjë me lirinë dhe me pavarësinë e vendit tonë. Unë nuk kam ndonjë element tjetër të shtoj, vetëm të falënderoj me

këtë rast Kuvendin e Kosovës për të gjitha angazhimet e veçanta që ka pasur gjatë gjithë procesit, për mbështetjen e madhe që i është dhënë Ekipit të Unitetit në punën e tij dhe gjithë Delegacionit të Kosovës dhe për mbështetjen e fuqishme të vizionit tonë të përbashkët dhe të paluhatshtëm për të ardhmen e Kosovës, për pavarësinë e Kosovës”.

Garantohet krijimi i shtetit të Kosovës dhe integriteti territorial i saj

Pastaj fjalën e mori Agim Çeku i cili tha :”Edhe unë si anëtar i Ekipit Negociator dhe si kryeministër



në emrin tim dhe në emër të Qeverisë së Kosovës e mbështes aprovimin e një deklaratë të këtillë të prezantuar para këtij Kuvendi dhe ftoj deputetët e Kuvendit që ta mbështesin dhe ta votojnë një deklaratë të tillë.

Qeveria beson se dokumenti i Ahtisarit ofron një zgjidhje të drejtë për Kosovën, Qeveria është e bindur se propozimi i Ahtisarit siguron balancën në mes të vullnetit të popullit tonë për pavarësi dhe kërkesave të pakicave për integritet dhe zhvillim në shtetin e ri të Kosovës.

Ky dokument pra garanton krijimin e shtetit të Kosovës dhe garanton integritetin territorial të Kosovës.

Duke e mbështetur këtë dokument ne do t'i japim mbështetje punës së Ekipit Negociator dhe gjithë strukturës njerëzore të përfshirë në këtë proces për punën që e ka bërë në përfaqësimin sa më besnik të intere-

save të popullit të Kosovës në bisedimet mbi njëvjeçare të bëra me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Akti juaj i sotëm do të ishte konfirmim i fuqishëm i partneritetit tonë me bashkësinë ndërkombëtare gjatë 8 vjetëve të fundit, por edhe në të ardhmen. Pavarësisht nga dallimet politike që kemi, ne kemi kultivuar një vlerë të jashtëzakonshme dhe esenciale për të ardhmen e shtetit të ri, unitetin për çështje madhore në interes kombëtar. Është e rëndësishme për Kosovën që procesi në të cilin hyjmë bashkërisht të na gjejë kështu bashkërisht edhe në fund të tij. Në rrafshin global procesi i pavarësimit të Kosovës është fitore e konsensusit ndaj politikës së koncesioneve, fitore e arsyes së shëndoshë ndaj emocioneve të verbra politike, fitore e së drejtës së popujve për liri dhe pretendimeve të vjetruara mbi territorin. Ne nuk kemi qenë të vetëm, gjatë gjithë këtyre viteve kemi pasur mbështetje të aleatëve dhe miqve tanë: të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe vendeve të tjera evropiane. Me këtë rast edhe unë në emër të Qeverisë dua t'i shpreh mirënjohje për punën e madhe që kanë bërë vendet e Grupit të Kontaktit, UNOSEKU në tërësi dhe në veçanti presidenti Marti Ahtisari.

Pavarësia që presim të finalizohet së shpejti nuk është në fakt fundi i procesit, ajo është fillimi i një rrugëtimi të ri, vizioni ynë parasheh integritetin e Kosovës në Unionin Evropian dhe në NATO.

Në fund duke ju ftuar që t'i jepni përkrahjen tuaj procesit përmes aprovimit të kësaj deklaratë të sotme, ju ftoj që të vazhdojmë të

mbetemi unikë ashtu si edhe deri më tani”.

Hap i madh dhe i sigurt drejt ndërtimit të shtetit tonë modern

Në vijim të pranishmëve iu drejtua z. Hashim Thaçi, i cili theksoi:”Takimi i sotëm nuk është i rastësishëm, është një proces i



gjatë, prandaj edhe ne të gjithë brenda pak dekadave kaluam sfida të mëdha, kaluam transicione të shumëfishta, nga regjimi komunist në shpërbërjen e plotë të Jugosllavisë. Nga shtypja dhe okupimi në luftën për çlirim, nga një administrim ndërkombëtar i plotë në vetëqeverisjen demokratike dhe tani jemi në fund të rrugëtimit tonë për pavarësinë e Kosovës. Në fakt në vendin tonë kanë ndodhur mrekullia, brenda pak dekadave ne kemi kaluar sfida që vendeve dhe popujve të tjerë u janë dashur shekuj, por me këtë ndërrim rrethanash kanë ardhur edhe përgjegjësi të reja, prandaj jemi përballur me sfida si popull gjithmonë, kemi demonstruar dinjitetin dhe fuqinë tonë.

Me pavarësinë vijnë edhe sfida të reja, sfida për të cilat kemi marrë edhe përgjegjësitë që na takojnë, por një gjë është e qartë, me pavarësinë vijnë edhe mundësitë e reja, me pavarësinë vjen krenaria, dinjiteti, vijnë ditë të reja, epokë e re nga e cila secili prej nesh kërkon më shumë punë për të arritur stabilitet, përparim, jetë më të mirë për qytetarët dhe vendin tonë.

Sot po vëmë themelet e memorialit më të rëndësishëm dhe më madhështor për atë që kanë sakrifikuar bashkërisht, për ata të cilët kanë sakrifikuar jetën e tyre, por edhe duke respektuar sot ne vullnetin e

qytetarëve të Kosovës, prandaj nga ne të gjithë sot kërkohet leadership dhe konsensus. Duhet të jemi shumë krenarë me përparimin që kemi arritur, por mbi të gjitha duhet të jemi krenarë që këtë rrugë e kemi bërë të bashkuar, të bashkuar si popull, por kemi ende punë për të bërë. E ardhmja do ta kujtojë dhe do ta shënojë atë që ne sot po bëjmë, do ta kujtojmë mënyrën se si jemi ballafaquar me sfidat para nesh, mënyra e vetme për t'i ballafaquar sfidat e së nesërme është duke qenë të bashkuar sot në deklarin tonë. Kemi besimin e palëkundur se të bashkuar mund të tejkalojmë çdo sfidë. Uniteti që ka mbizotëruar në mes të popullit të Kosovës dhe politikës në luftën tonë të drejtë ka qenë i palëkundur. Ky unitet, i cili nuk ka qenë kurrë më i fuqishëm se sot, ky unitet i cili nuk ka qenë kurrë më i madh se sot, është hap i madh dhe i sigurt drejt ndërtimit të shtetit tonë modern.

Veprimet e përbashkëta janë garanci për muajt dhe vitet që kemi para nesh. Uniteti sot është garanci që themelet e shtetit tonë të lirë dhe të pavarur të jenë themele stabile dhe të forta. Sot jemi të ftuar të punojmë bashkërisht, jo vetëm për një të ardhme më të mirë në sferën e mirëqenies dhe të përparimit, por mbi të gjitha t'u sjellim vendit dhe qytetarëve tonë respekt, dinjitet dhe nderë. Por, sot, ne jemi të gatshëm të qëndrojmë në këmbët tona si një shtet i pavarur dhe sovran dhe partner i sigurt i botës demokratike. Ne jemi të gatshëm për t'u përballur me sfidat e reformave, me zhvillimin ekonomik dhe me procesin e modernizimit. Ne jemi të gatshëm dhe të përgatitur, kemi vullnet dhe energji që ta ndërtojmë infrastrukturën e nevojshme që Kosovën ta sjellim në shekullin 21 dhe në Evropë. Ne jemi të gatshëm dhe të përgatitur, por hapin e parë, të nderuar deputetë, duhet ta bëjmë sot. Qëndrojmë sot këtu krenarë me atë

që kemi bërë për qytetarët dhe për vendin dhe mbi të gjitha me shpresë dhe në pritje për një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë.

Të nderuar deputetë

Po fillon sot një epokë e re, epoka e premtiveve dhe e shpresës, epoka e paqes dhe e stabilitetit, epoka e mundësive të reja. Një epokë e re po fillon dhe ajo merr rrënjë nga vota jonë sot për Deklaratën e propozuar. Prandaj, të nderuar deputetë, ju ftoj të gjithëve që të votoni “po”, votoni “po” në mënyrë që të mund të hapim këtë kapitull të ri, Kosova vend i qytetarëve të Kosovës, votoni “po” në mënyrë që bota të na e dëgjojë qartas dhe zëshëm vullnetin e qytetarëve të Kosovës, votoni po me zë të bashkuar për propozimin për të ardhmen e Kosovës, “po” për partneritetin e Kosovës me botën Perëndimore. Kosova mirëpret dokumentin e presidentit Ahtisari. Kosova mirëpret prezencën civile ndërkombëtare dhe NATO-n, Kosova merr përgjegjësi për implementimin e marrëveshjes së presidentit Ahtisari, pra Kosova pret vendimin për Kosovën e pavarur dhe sovranë me deklarin tonë unik për Deklaratën e presidentit apo propozimin e presidentit Ahtisari”.

Kosova po shndërrohet në shtet të barabartë me popujt e tjerë në një bashkësi të lirë shtetesh

Pastaj fjalën e mori Veton Surroi, i cili u shpreh:”Është një nder i veçantë që këtu t'i ndajmë këto momente



solemne së bashku, sepse ky rrugëtim me çfarëdo dallime të interpretuara në këto vite, megjithatë ka qenë rrugëtim i përbashkët. Ky moment koincidon

Deklaratë e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të Raportit dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës të Martti Ahtisaarit, të dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj deklarate mirëpret raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, duke besuar se rekomandimet e tij paraqesin një zgjidhje të drejtë dhe të balancuar, që është në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës. Pranon dhe zotohet të implementojë plotësisht Propozimin gjithëpërfshirës të marrëveshjes për statusin e Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars të vitit 2007 dhe deklaron, nën supozimin që Marrëveshja është e pranueshme për Këshillin e Sigurimit, se dispozitat që i përmban marrëveshja do të jenë ligësisht të obligueshme për Kosovën.

Mirëpret pa rezervë praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë që do të krijohet në Kosovë, siç parashihet në Marrëveshje dhe zotohet se do të bashkëpunojë dhe do ta mbështesë këtë prani në çdo mënyrë të mundshme, përderisa kjo prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë t'i kryejë detyrat që i janë dhënë në Marrëveshje.

Prishtinë, më 5 prill 2007

me një moment para 8 vjetësh, kur në këso kohe Kosova filloi në formë dramatike partneritetin e vet me bashkësinë ndërkombëtare. Atëherë Delegacioni i Kosovës në kushte të jashtëzakonshme, duke luftuar për jetë a vdekje, nënshkroi partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare dhe për herë të parë Kosova me Marrëveshjen e Rambujes u vu nën ombrellën mbrojtëse të aleancës më të madhe, më të fuqishme që ka njohur historia e njerëzimit, të aleancës së NATO-s.

Aso kohe, po ashtu, ndodhi një kthesë dramatike në jetën e Kosovës dhe të kosovarëve, për herë të parë në historinë e kësaj treve dhe të këtij populli Kosova u vu në vijën e drejtë të historisë, në vijën e cila fiton në histori. Asnjëherë më parë nuk kemi qenë në atë lundrim historik, i cili tashmë shpinte drejt fitores.

Sot jemi në një situatë krejtësisht tjetër, shumë më të mirë ekzistencialisht, të mbrojtur, por është pjesë e njëjtë e partneritetit të cilin e nënshkruam, ka të bëjë me zgjerimin e këtij partneriteti, ka të bëjë me zgjerimin e natyrës së këtij partneriteti dhe të pasojave që do të rrjedhin nga ky partneritet.

Vullneti i popullit të Kosovës për pavarësi nuk mbetet në këtë partneritet vetëm vullneti i këtij populli, por njihet si interes i botës demokratike. Ajo që ndodhi më 26 mars dhe ajo që ndodhi dje në praninë edhe të kryetarit Sejdiu ishte në të vërtetë akti në të cilin vullneti i qytetarëve të Kosovës u shndërrua në pozicion të mbrojtur nga Perëndimi, dhe kjo ishte një kthesë e jashtëzakonshme për të gjitha ato vite dhe për të gjitha ato lëvizje që kanë çuar deri te kjo situatë. Në fakt, ajo që ndodhi më 26 mars ishte njohja e së drejtës së

shtetit të Kosovës për t'u bërë pjesë e bashkësisë së shteteve.

Në 100 vjetët e kaluar, në tërë shekullin e kaluar u bë një përpjekje e jashtëzakonshme e shumë lëvizjeve, e shumë individëve e tërësisë për të qenë të barabartë. Kërkesa për barazi, për barazinë e Kosovës, të qytetarëve të saj, popullit të saj, posaçërisht u rithekua pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo çka nuk u arrit në ish-Jugosllavi, që Kosova të jetë e barabartë me popujt e tjerë po mbërrihet sot zonja dhe zotërinj, Kosova po shndërrohet në shtet të barabartë me popujt e tjerë në një bashkësi të lirë shtetesh, në një botë krejtësisht të re. Njëkohësisht sot është nder që çështja e Kosovës të jetë shndërruar në çështje që bashkon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, çështje që bashkon edhe ato shtete brenda Bashkimit Evropian, të cilat mund të kenë pasur dyshime, çështje e cila bashkon kulturat e ndryshme, bashkon shtetet e krishtera, ato islamike, ato me sfond budist. Kosova është çështje globale po i bashkon të gjitha këto vende dhe të gjitha ato lëvizje të cilat kanë qenë liridashëse dhe të cilat kanë krijuar shtetet e veta.

Ajo që bëjmë ne sot, propozojmë që të bëjmë një deklaratë, është vetëm të theksojmë se ky Kuvend i Kosovës, se kjo Kosovë është e gatshme për zgjerim të këtij partneriteti në këtë shekull, në këtë bashkësi të lirë shtetesh”.

Pas kësaj kryeparlamentari Berisha para të pranishmëve lexoi tekstin e deklaratës të hartuar dhe të harmonizuar mbrëmë nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe anëtarët e Grupit të Unitetit, si dhe nga shefat e partive politike. Deklarata u aprovua nga deputetët e shoqëruar edhe me duartrokitje, ndërsa vetëm një votë ishte kundër.

Sa më shpejt të njihet pavarësia e Kosovës

- *Ditën e parë të vizitës parlamentarë të Kosovës u takuan me nënkryetarin e Bundestagut, Wolfgang Thierse dhe me sekretarin e përgjithshëm të Bundestagut Gjerman, Hans-Joachim Stelzl*
- *U bisedua për bashkëpunimin ndërparlamentar ndërmjet Bundestagut dhe Kuvendit të Kosovës, por edhe për çështjen e statusit të Kosovës*

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryetari Kolë Berisha, në përbërje të të cilit janë edhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti e Gazmend Muhaxheri, filloi sot vizitën dyditëshe në Bundestagun e Gjermanisë, vizitë kjo e organizuar nga projekti “Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës”, gjatë së cilës delegacioni i Kuvendit të Kosovës do të ketë takime me zyrtarë të lartë të Bundestagut Gjerman dhe me udhëheqës e drejtues të programeve e të departamenteve të ndryshme, për të parë përvojat e punës së Bundestagut Gjerman, për tu njoftuar me rolin dhe funksionimin e grupeve parlamentare, të Presidiumit e të Këshillit të Pleqësisë së Bundestagut Gjerman, për mënyrën e aprovimit të ligjeve, për marrëdhëniet me publikun, për metodat e punës së komisioneve, për marrëdhëniet ndërkombëtare në Bundestagun Gjerman etj.

Pas mikpritjes zyrtare që iu bë sot në mëngjes delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Bundestagun Gjerman, delegacioni i parlamentarëve të Kosovës pati një takim me nënkryetarin e Bundestagut, zotëri Wolfgang Thierse.

Në takimin me nënkryetarin e Bundestagut Gjerman, delegacioni i Kuvendit të Kosovës bisedoi për bashkëpunimin ndërparlamentar ndërmjet Bundestagut dhe Kuvendit të Kosovës, por u bisedua edhe për çështjen e statusit të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha e falënderoi z. Wolfgang Thierse, për ndihmën e madhe që ka dhënë dhe po jep Bundestagu Kuvendit të Kosovës, në kuadër të Konzorciumit të katër parlamenteve që janë të pranishme në



Kuvendin e Kosovës me programin “Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës”.

Kryeparlamentari Berisha e njoftoi nikoqirin gjerman për punën e Kuvendit të Kosovës dhe për misionin kryesor që ka Kuvendi për bërjen e Kosovës me ligje funksionale dhe efikase dhe të mbështetura në standarde evropiane dhe ndërkombëtare.

Zotëri Berisha i tha nënkryetarit të Bundestagut Gjerman, zotëri Thierse se e çmon shumë ndihmën që ka dhënë dhe po jap Gjermania, pra edhe Bundestagu, për Kosovën dhe kërkoi që Gjermania si faktor kyç në Unionin Evropian, të përkrah pavarësinë e Kosovës, sepse Kosova, shtet i pavarur, nuk e dëmton askënd, përkundrazi është faktor stabiliteti në rajon. Ne jemi të gatshëm të trokasim në dyert e Bashkësisë Evropiane, prandaj me fuqinë që keni si shtet i fortë, si Gjermani të ndikoni që sa më shpejt të njihet pavarësia e Kosovës, i ka thënë zotëri Berisha nikoqirit gjerman.

Nënkryetari i Bundestagut Gjerman, zotëri Wolfgang Thierse, tha se

Bundestagu dhe Qeveria Gjermane përkrahin Dokumentin e Ahtisarit, se veprimet që do të ndërmerren në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara do të jenë pozitive, por pavarësia nuk do të thotë zgjidhje e problemeve brenda nate. Në Kosovë do të mbeten edhe shumë punë për tu bërë në të ardhmen, tha ai.

Të dy bashkëbiseduesit, por edhe anëtarët e Kryesisë të Kuvendit të Kosovës që u inkuadruan në bisedë, u pajtuan se duhet vazhduar bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe parlamenteve të vendeve evropiane, se projekti evropian për ndihmë Kuvendit të Kosovës është shumë i suksesshëm dhe se duhet vazhduar më tej, kurse Kuvendi i Kosovës do t’i shfrytëzojë përvojat më të mira demokratike të vendeve të Evropës dhe të botës.

Delegacioni i parlamentarëve kosovarë u takua po sot edhe me sekretarin e përgjithshëm të Bundestagut Gjerman, zotëri Hans-Joachim Stelzl, ndërsa nesër priten të realizohen edhe takime të tjera, në kuadër të kësaj vizite.

Në seancën plenare të Parlamentit Evropian të votohet me emër të saktë për pavarësinë e Kosovës

Takime shumë të frytshme me kryetarin e Parlamentit të Evropës, Hans - Gert Pottering, me kryetarin e Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, Jacek Saryusz-Wolski, me autorin dhe raportuesin e Rezolutës për të ardhmen e Kosovës, Joost Lagendijk, si dhe me grupe deputetësh të formacioneve të ndryshme politike në Parlamentin Evropian

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tij, gjatë vizitës në Strasburg është takuar me kryetarin e Parlamentit të Evropës, Hans – Gert Pottering. Temat kryesore të bisedës kanë qenë bashkëpunimi me Parlamentin Evropian, roli i Parlamentit të Evropës dhe i Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe çështja e Rezolutës, e cila pas Komisionit të Jashtëm do të shtrohet për votë finale në Parlamentin Evropian, në fund të këtij muaji.

Në një pritje miqësore z. Pottering u interesua për zgjidhjen e statusit të Kosovës, sipas planit të presidentit Ahtisari, si dhe për mënyrën se si do të kalojë propozimi i Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Kryetari i Kuvendit, z. Berisha, në këtë takim prezantoi elemente të shumta mbrojtëse për të drejtat e minoriteteve . Ai theksoi se zgjidhja e çështjes së Kosovës nuk paraqet precedent për rajonet e tjera, por është rast i veçantë. Kosova e pavarur, tha ai, do të jetë shtet i qytetarëve të saj të barabartë, faktor stabiliteti në rajon dhe me marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha vendet e rajonit.

Kryetari Berisha foli për përcaktimin e qartë të Kosovës për integrimet evropiane.

Zotëri Pottering theksoi se Kosova dhe tërë rajoni kanë një të ardhme evropiane. Sa më shumë bashkëpunim e raporte të mira që keni, do të jetë më lehtë për ne dhe për ju, tha z. Pottering. Kryetari i Parlamentit Evropian, z. Pottering, premtoi se do t'i bëjë vizitë Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, sa po ta lejojnë angazhimet e tij dhe agjendat e punës në Parlamentin



Evropian. Ai e ftoi kryeparlamentarin Berisha që të nënshkruhet në Librin e vizitorëve të Parlamentit Evropian.

Kryeparlamentari Berisha u takua sot edhe me kryetarin e Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Parlamentit Evropian, Jacek Saryusz-Wolski.

Një bisedë e përzemërt u zhvillua me dy deputete nga grupi i të gjelbërve, Angelika Beer dhe Gisela Kallenbach. Kryetari i Kuvendit të Kosovës takoi po ashtu edhe autorin dhe raportuesin e Rezolutës për të ardhmen e Kosovës, Joost Lagendijk, të cilin e ka falënderuar për formulim të saktë në kërkesën e pavarësisë për Kosovën. Fakti se Rezoluta nuk kaloi mbrëmë për një votë, nuk është mospër sukses, përkundrazi, është hap i rëndësishëm në drejtim të duhur, ka theksuar Berisha.

Zotëri Lagendijk u shpreh optimist se zgjidhja e propozuar deri në Seancën Plenare që do të mbahet në fund të muajit, do ta ketë edhe emrin dhe shtoi se Rezoluta, kështu siç është miratuar, ka përmbajtje të mirë. Ai ka përkrahur

plotësisht propozimin e z. Ahtisari dhe ka rikonfirmuar se nuk do të ketë ndarje të Kosovës.

Takimet e paradites janë zhvilluar edhe me grupe të deputetëve nga disa grupacione politike, të cilat kanë përkrahur formulimin “pavarësi për Kosovën” në raportin e z. Lagendijk.

Kryeparlamentari Berisha i vlerësoi shumë të dobishme takimet dhe sugjerimet që u ofruan nga eurodeputetët Doris Pack dhe Berndt Posselt, të dy njohës të mirë të rrethanave në Kosovë. Në këtë frymë kaloi edhe takimi me dhjetë eurodeputetë, përfaqësues të disa vendeve nga Grupi i Liberaldemokratëve. I tërë grupi i Liberaldemokratëve ka votuar propozimin e paraqitur si kompromis nga z. Lagendijk. Në këtë grup ishte e panevojshme të bëheshin shpjegime të detajizuara, sepse ata i dinë dhe i thonë publikisht angazhimet e tyre në mbështetje të Kosovës.

/ vijon në faqen 10 /

/ vijon nga faqja 9 /

Fokus i bisedës me këtë grup ishte periudha e passtatusit në Kosovë, garancitë për minoritetet, roli i Bashkimit Evropian dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës.

Kryetari i Kuvendit falënderoi këta eurodeputetë për angazhimet e tyre dhe theksoi rëndësinë bashkëpunimit të mëtejshëm.

Grupi i Socialistëve në Parlamentin Evropian ka votuar kundër formulimit “pavarësi” e “soveranitet”, por sipas tyre kjo është bërë për shkak se i takon z Ahtisari të bëjë propozimin e jo Parlamentit Evropian. Pikërisht për këto dallime në qasje dhe hezitimeve të tjera, takimi me këtë grup ishte mjaft i rëndësishëm dhe me interes të veçantë. Në këtë frymë kryetari i Kuvendit të Kosovës i takoi tre drejtuesit e këtij grupi: z Hannes Swoboda, Csaba Sandor Tabajdi dhe z. Libor Rouček. Të gjithë këta treguan se nuk kanë ndonjë pozicionim të qartë kundër Kosovës, por ata duan zgjidhje për tërë popujt dhe për tërë rajonin.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, ka sugjeruar në këtë takim se ka nevojë për më shumë takime dhe informacione, sepse në disa qarqe të caktuara ende ka mosnjohje të proceseve në Kosovë dhe për Kosovën.

Pa përjashtim, në të gjitha takimet e zhvilluara sot në Strazburg, vizita u vlerësua e rëndësishme. Ishte ky rast i mirë për të shpjeguar hollësi për zhvillimet në Kosovë, për Kuvendin e Kosovës, për përmbushjen e standardeve për status, për garancitë që u ofrohen minoritete, dhe mbi të gjitha, për t’u përgjigjur në të gjitha aspektet që ende janë burim i hezitimeve në drejtim të statusit të Kosovës.

Në të gjitha takimet që pati sot kryeparlamentari Berisha falënderoi të gjithë ata që u angazhuan për Rezolutën për Kosovën dhe bëri thirrje që në Seancën Plenare të Parlamentit Evropian të votohet me emër të saktë për pavarësinë re Kosovës, duke shfaqur bindjen se parlamenti Evropian do ta bëjë këtë.

E ardhmja e Kosovës gjithsesi do të jetë anëtarësimi në Unionin Evropian

Parlamentarët kosovarë i kanë përkujtuar konstitucionalistit francezë se Komisioni i Badinterit kishte anashkaluar çështjen e Kosovës, pasojë e së cilës ishte lufta që shkaktoi krizën humanitare dhe intervenimin e forcave të NATO-s ndaj forcave serbe, duke krijuar një realitet të ri në Kosovë

Konstitucionalisti i njohur francez, Robert Badinter dhe akademiku Tieri Montbrial, të shoqëruar nga shefi i Zyrës franceze në Prishtinë, Tiery Reinard janë pritur sot në një takim të për-



bashkët nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe të komisioneve parlamentare, në të cilin kanë këmbyer mendime për Pakon e Ahtisarit dhe për statusin politik të Kosovës.

Pasi i kanë vlerësuar meritat e Komisionit të Badinterit për shpërbërjen e Jugosllavisë, parlamentarët kosovarë ia kanë përkujtuar konstitucionalistit francez se atë botë ishte anashkaluar çështja e Kosovës, pasojë e së cilës qe lufta në Kosovë, që shkaktoi një krizë humanitare intervenimin e forcave të NATO-s ndaj forcave serbe, duke krijuar një realitet të ri në Kosovë.

Anëtar i Kryesisë, Sabri Hamiti, i cili e ka drejtuar takimin, e ka pyetur troç z. Bandinter, nëse ai e përkrah Pakon e Ahtisarit dhe pavarësinë e Kosovës.

“Është tepër vonë për këshilla dhe sugjerime juridike dhe është herët për konstatime politike”, ka thënë Badinter. “Ju jeni të zotët e Kosovës, e keni pranuar Pakon e Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe vetëm mund të uroj që ajo edhe të pranohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së”, ka thënë juristi i njohur francez. Akademiku, Tieri Montbrial, ndërkaq, ka theksuar se vendimet në KS të OKB-së, më shumë se nga parimi i së drejtës varen nga raporti i forcave të faktorëve relevant ndërkombëtar. “E ardhmja e Kosovës gjithsesi do të jetë anëtarësimi në Unionin Evropian, por jo që nesër”, ka thënë Badinter.

Parlamentarët e Kosovës u kanë bërë pyetje të shumta mysafirëve francezë, nga përgjigjet e të cilëve nuk janë ndarë shumë të kënaqur, kurse Sabri Hamiti e ka përfunduar takimin me konstatimin: “Ju vetë thatë se flisni si intelektual dhe analistë, ndërkaq, intelektualët, përfshirë edhe mua, janë skeptikë, prandaj duam më shumë t’i besojmë qëndrimit të shtetit francez për statusin e Kosovës, të shfaqur kohëve të fundit”.

“Përcillja popullit të Kosovës bekimin dhe angazhimin tim”, porositi Papa kryeparlamentarin Berisha

Kryeparlamentari Berisha së pari mori pjesë në një audiencë më të gjerë të Papa Benediktit XVI, ndërsa pas kësaj pati një takim zyrtar sy më sy me Atin e Shenjtë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, i cili, me bashkëpunëtorë, po qëndron për një vizitë zyrtare në Vatikan, u takua sot në Selinë e Shenjtë me Atin e Shenjtë Papa Benedikti XVI. Kryeparlamentari Berisha së pari mori pjesë në një audiencë më të gjerë të Papa Benediktit XVI, ndërsa pas kësaj pati një takim zyrtar sy më sy me Atin e Shenjtë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, fillimisht e informoi Atin e Shenjtë se vjen para Shenjtërisë së Tij nga një popull i vogël, por më i vjetri në Ballkan, i cili njerëzimit dhe Selisë së Shenjtë ia dha Papa Klimentin XI, ose si quhet edhe Papa Albani, ilir, i cili që në shekullin II e kishte bekuar popullin gjerman; ia dha Shën Jeronimin, përkthyesin e parë të Biblës; ia dha Shën Niketë Dardanin, njohësin më të mirë të traditës artistike dhe diturore, i cili hartoi një numër të madh veprash filozofike, teologjike dhe ishte muzikanti më i madh i të gjitha kohërave; ndërkaq, në shekullin II, po ky popull i vogël, ia dha martirët e parë kishës katolike – Shën Florin dhe Shën Laurin, dardanë, të cilët, foltoren pagane që e kishin ndërtuar vetë, ia kushtuan Krishtit; ia dha patrikun ekumenik Atanagora; pastaj, në shekullin XIV, Evropës dhe botës së krishterë në tërësi ia dha Gjergj Kastrioti-Skënderbeun, i cili për plot 24 vjet, duke luftuar kundër Perandorisë



TAKIMET E KRYETARIT TË KUVENDIT

Osmane, e mbrojti Evropën nga sulmet e Perandorisë Osmane dhe për këtë Selia e Shenjtë e quajti atëbotë Atlet i Krishtit; kurse, së voni, në shekullin XX, ky popull ia dha njerëzimit edhe Nënë e Madhe, Nënë Tereze.

Pas kësaj, kryeparlamentari Berisha e informoi Atin e Shenjtë, Papa Benedikti XVI, edhe për aktualitetin politik nëpër të cilin po kalon sot Kosova, e informoi për ecurinë e negociatave në Vjenë lidhur me përpjekjet për gjetjen e zgjidhjes për statusin final të Kosovës, proces ky që po zhvillohet nën kryesimin e presidentit Marti Ahtisari. Pala kosovare, gjatë tërë këtij procesi, ishte konstruktive dhe e përkushtuar që t'i kontribuojë zgjidhjes sa më të pranueshme për të dy palët. Berisha e informoi Atin e Shenjtë edhe për punën e Ekipit të Unitetit të Kosovës, por edhe për garancitë dhe të drejtat që i janë ofruar e që po i ofrohen komuniteteve që jetojnë në Kosovë, veçanërisht komunitetit serb.

Kryeparlamentari Berisha i tha Papa Benediktit XVI se, vendi prej nga vjen, Kosova, tani po kalon nëpër momentet më vendimtare në historinë e saj, kur duhet të përcaktohet fati i të ardhmes së saj, që nënkupton zgjidhjen e statusit të Kosovës, ndërsa vullneti i popullit shumicë në Kosovë, pra vullneti i shqiptarëve, është Kosova shtet i pavarur dhe sovran, me të gjitha garancitë për të gjithë ata që jetojnë në të, pa dallim të përkatësisë kombëtare, fetare, racore, gjinore e të tjera, një shtet që do të jetë pjesë e familjes së madhe evropiane dhe në miqësi të përherëshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e integruar në të gjithë mekanizmat euroatlantikë.

“E luta Shenjtërinë e Tij, Papa Benediktin XVI, ta bekojë Kosovën dhe popullin shqiptar dhe me autoritetin që ka Selia e Shenjtë në gjithë botën të ndikojë që ky proces, pra procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës, të përshpejtohet dhe të jetë

në pajtim me vullnetin e shumicës dhe me garancionet për komunitetet”, tha z. Kolë Berisha pas takimit me Atin e Shenjtë në Vatikan. Një pjesë të takimit, kryeparlamentari Berisha e shfrytëzoi për ta informuar Atin e Shenjtë edhe për punën e institucioneve të Kosovës, e në veçanti për punën e Kuvendit të Kosovës në aprovimin e ligjeve që janë kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare si standarde.

Kryeparlamentari Berisha, pas takimit me Atin e Shenjtë, tha se Shenjtëria e Tij mirëpriti informacionet që mori për Kosovën dhe për popullin e saj, ndonëse nga biseda që pati me të u fitua përshtypja se Ati i Shenjtë ishte i informuar mirë për të gjitha zhvillimet në Kosovë dhe për Kosovën dhe premtoi se do të angazhohet për një zgjidhje të drejtë për t'iu kthyer të ardhmes dhe për krijimin e një klime të tillë ku të gjithë do të jetojnë të qetë, në paqe e në harmoni të plotë.

“Të lutem, përcillja popullit të Kosovës bekimin tim dhe siguroje atë që unë do të angazhohem që ky popull të jetojë në paqe, të ruajë traditën dhe entitetin e vet”, e porositi Ati i Shenjtë, papa Benedikti XVI, kryeparlamentarin Berisha.

Në fund të këtij takimi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, e ftoi Atin e Shenjtë që ta vizitojë Kosovën.

Italia do të vazhdojë edhe më tutje të jetë aktive dhe të bëjë punën e vet

Gjatë vizitës zyrtare në Vatikan, kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, u takua sot në Romë me kryetarin e Komisionit për Politikë të Jashtme të Dhomës së Deputetëve të Parlamentit të Italisë, z. Umberto Ranieri.

Kryeparlamentari Berisha fillimisht e falënderoi zotin Ranieri për ndihmën që Italia i dha Kosovës gjatë dhe pas luftës dhe e falënderoi për qën-

drimin konstruktiv që po mban Italia si anëtare e Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e drejtë të statusit të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha e informoi z. Ranieri për zhvillimet më të reja në Kosovë dhe për Kosovën në këtë kohë kur po bëhen kilometrat e fundit deri te zgjidhja e statusit të Kosovës, që do të jetë pavarësia.

“Ne aspirojmë që sa më shpejt të jemi pjesë e bashkësisë evropiane dhe e mekanizmave të tjerë euroatlantikë, prandaj kërkojmë që Italia të ndikojë në përshpejtimin e procesit të zgjidhjes së statusit të Kosovës. Kjo, sepse Kosova do të jetë faktor stabiliteti në rajon dhe ajo është e përkushtuar për ndërtimin e një të ardhme të mirë e të lumtur për të gjithë, për marrëdhëniet të mira ndërfqinjësore, pra edhe me Serbinë”, i tha Berisha z. Ranieri.

Në këtë takim, kryeparlamentari Berisha e informoi nikoqirin edhe për punën e Kuvendit të Kosovës, sidomos në aprovimin e ligjeve që janë pjesë e standardeve të caktuara nga bashkësia ndërkombëtare.

Kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të Dhomës së Deputetëve të Parlamentit të Italisë, z. Umberto Ranieri, tha se vlerëson jashtëzakonisht angazhimin e krerëve të institucioneve të Kosovës për stabilizimin e Kosovës dhe për t'i dhënë një frymë demokratike vendit. Ne, tha ai, angazhohemi që statusi të zgjidhet në Këshillin e Sigurimit në mënyrë sa më pozitive dhe t'i plotësojë dëshirat e të gjithëve. Italia do të vazhdojë edhe më tutje të jetë aktive dhe të bëjë punën e vet. Ushtarët tanë edhe më tutje do të jenë prezentë me qellim të garantimit të paqes në rajon. E ardhmja është respektimi i të drejtave të të gjithëve dhe fqinjësia e mirë me shtetet e rajonit dhe më gjerë.

Në takim u bisedua edhe për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit të Italisë.

Për një dinamikë më të mirë të procedimit të projektligjeve pas leximit të parë

Për shkak të mospajtimit të dy komisioneve parlamentare për çështje kompetencash po vonohet miratimi i Projektligjit për ushqimin



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pasur sot një takim të përbashkët me kryetarët e komisioneve parlamentare, me të cilët ka biseduar për planet e punës së komisioneve për vitin 2007 dhe për një dinamikë më të mirë të procedimit të projektligjeve, pas leximit të parë.

Në takim është konstatuar se shumica e komisioneve parlamentare i kanë miratuar planet e punës ose janë në përfundim e sipër, ndërkaq, ka pasur ankesa se për shkak të mungesës së planit të përpiktë të ministrive për dinamikën e hartimit të ligjeve të caktuara, nuk ka mundur të parashihet saktësisht dinamika e punës së komisioneve për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve.

Në këtë takim, kryeparlamentari Berisha ka kërkuar një punë shumë më dinamike të komisioneve parlamentare, duke pasur parasysh se Kuvendit do t'i vijë shumë shpejt për miratim edhe një varg ligjesh sistemore, të parapara në Planin e

Ahtisarit për statusin e Kosovës. Si shembull se si në ndonjë rast vonon miratimi i ligjeve shumë të nevojshme për Kosovën është përmendur Ligji për Ushqimin. Për shkak të mospajtimit të dy komisioneve parlamentare për çështje kompetencash (ndërmjet Komisionit për Shëndetësi dhe atij për Bujqësi) po vonohet miratimi i këtij projektligji, prandaj është kërkuar që kryeparlamentari t'i takojë këto dy komisione dhe të ndikojë që të tejkalohen mosmarrëveshjet.

Në takim është konstatuar se disa ligje të miratuara nuk po gjejnë zbatim të plotë, kurse ka pasur kritika edhe për disa ministri, të cilat në emër të efikasitetit në planin e zbatimit të ligjeve, nxjerrin urdhëresa administrative, të cilat nuk udhëzojnë se si të zbatohet ligji, por thjesht marrin karakterin e normave juridike, që shkakton konflikt kompetencash ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit të vendit.

Letër e Sabri Hamitit dërguar katër senatorëve amerikanë

Prishtinë, 10 prill 2007

Senatorit Joe LIEBERMAN

Senatorit Joseph BIDEN

Senatorit John MCCAIN

Senatorit Gordon SMITH

Të nderuar senatorë,
Dëshiroj që në emër të Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës t'ju shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tonë për nismën tuaj që Senati të miratojë rezolutë (S.RES.135) që kërkon mbështetje të SHBA-ve për pavarësinë e Kosovës.

Pavarësia për Kosovën është zgjidhja e vetme e drejtë dhe e qëndrueshme, që do të jetë në shërbim të gjithë popullit të Kosovës.

Shfrytëzoj rastin që t'ju shpreh vlerësimin tonë të thellë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme, e cila vazhdon edhe tani, për kauzën e drejtë të popullit të Kosovës për liri, demokraci dhe pavarësi.

Populli i Kosovës njeh dhe do të nderojë përgjithmonë sakrificat që ka bërë populli i Shteteve të Bashkuara për Kosovën, duke i dalë popullit tonë në ndihmë kur ka qenë nevoja që nga vitet e nëntëdhjeta.

Të nderuar senatorë – zoti Lieberman, zoti Biden, zoti McCain, dhe zoti Smith – ju lutem pranoni edhe një herë shprehjen e respektit dhe konsideratës tonë më të lartë.

**Dr. Sabri Hamiti, kryetar Komisioni për Politikë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës
Kuvendi i Kosovës
Rruga Nëna Tereze p.n.
10 000 Prishtinë**

Themelohet njësi moderne dhe funksionale e Arkivit të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës do të ketë një Arkiv të pajisur mirë me dokumente zyrtare që ai i miraton, por edhe me librin që do t'ia ofrojë deputetit, me dokumentin për hulumtime shkencore, të administruar mirë nga punëtorët e Kuvendit



Kuvendi i Kosovës, Arkivi i Kosovës dhe Projekti i UE-së “Mbështetje e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës” nënshkruan sot në mënyrë solemne Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet këtyre institucioneve, që ka të bëjë me projektin e përbashkët për themelimin e një njësie moderne dhe funksionale të Arkivit të Kuvendit të Kosovës. Projektin e nënshkruan z. Kolë Berisha, Kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe dr. Jusuf Osmani, drejtor i Arkivit të Kosovës dhe udhëheqësi i projektit

“Mbështetje e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës”, Hugues Courtivron. Në solemnitet merrnin pjesë edhe përfaqësues nga OSBE-ja, Anglia dhe Honkongu.

Në fillim të këtij solemniteti foli drejtori i Arkivit të Kosovës, **Jusuf Osmani**, i cili pasi përshëndeti të gjitha subjektet të cilat ndihmuan realizimin e këtij projekti tha: “Punëtorët arkivorë të Kosovës zotohen se do t’i kryejnë të gjitha detyrat që ia parashtron shoqëria në realizimin e objektivave përkitazi me funksionimin e shërbimit

arkivorë në Kosovë dhe në mbrojtjen dhe prezantimin e dokumenteve të shkruara. Këto detyra po i realizojmë në mbështetje të plotë të Zyrës së Kryeministrit, si dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me shumë arkiva të botës.

Veprimtarinë e vet Arkivi po e zgjeron edhe në menaxhimin arkivorë në institucionet tona ku krijohen dokumentet e shkruara në letër, tani edhe në formë elektronike, aty ku krijohet historia jonë, duke krijuar arkiva të veçanta, si pjesë e sistemit tonë integral

arkivorë, siç është rasti konkret me Arkivin e Kuvendit të Kosovës.

Ne arkivistët, do të angazhohemi që jo vetëm Kuvendit të Kosovës, por edhe të gjitha institucioneve tona do t'iu ndihmojmë në organizim dhe funksionim sa më bashkëkohor të shërbimit të arkivorë.”

Kryeparlamentari Berisha në fjalën e tij theksoi:” Këto ditë, derisa bisedonim për finalizimin e këtij projekti, një thënie e Federik Garsia Lorkës, se, “Në mendje ruaj një arkiv të tërë kujtimesh femijërore për kuvendimet me njerëzit”, sikur më vuri para një pyetjeje: prej nga kjo ngjashmëri e mendimit të Lorkës, me një pjesë të realitetit tonë?

Dhe, përfundimi: Në mungesë të shkrimit dhe të institucioneve tona, një pjesë e madhe e të kaluarës sonë, e historisë sonë, e kulturës sonë, e dëshmimeve tona dokumentare, për fat të keq, u ruajt, për aq sa mund të ruhej, vetëm në mbamendjen e paraardhësve tanë, vetëm përmes bisedave që zhvilloheshin nëpër kullat tona, nëpër odat tona dhe përcilleshin brez pas brezi, deri të ne – pasardhësit e tyre të vonuar.

Mendova: megjithatë, më mirë vonë, se kurrë.

Kohë më parë, ishim jo vetëm dëshmitarë, por edhe protagonistë të një akti solemn dhe shumë të rëndësishëm kulturor: Kuvendi i Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Universitare e Kosovës, të mbështetur nga Projekti “Mbështetje për Kuvendin e Kosovës” të Konsorciumit të katër parlamenteve të Evropës (Parlamenti Francez, Gjerman, Slloven dhe ai Belg) nëshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit, i cili shënoi futjen e librit edhe në Kuvend.

Ndërkaq, sot, jemi tubuar këtu, në mjediset e këtij institucioni – Arkivit të Kosovës – që unë do ta quaja Mbamendje institucionale e historisë, për një akt, po ashtu solemn dhe po aq të rëndësishëm

kulturor sikurse i pari, nëshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit të Kosovës, në njërën anë, dhe të Arkivit të Kosovës, në anën tjetër.

Me nëshkrimin e këtij Memorandumit, po fillojmë sot edhe zyrtarisht realizimin e një projekti, i cili, kur të finalizohet, do të mundësojë që Kuvendi i Kosovës të ketë një Arkiv modern, të pajisur mirë me dokumente zyrtare që ai i miraton, por edhe me librin që do t'ia ofrojë deputetit, me dokumentin për hulumtime shkencore, të administruar mirë nga punëtorët e Kuvendit, të përgatitur dhe të aftë, njësoj si kolegët e tyre të kuvendeve me përvojë të gjatë të pajisjes, të arkivimit dhe të ruajtjes së lëndës arkivore.

Këtë do ta bëjmë në bashkëpunim me Arkivin e Kosovës dhe me mbështetjen nga Projekti për mbështetje Kuvendit.

Më këtë rast, unë nuk dua të lëshohem në detaje të këtij projekti që, me nëshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, sot po e zyrtarizojmë. Por, dua të shpreh bindjen time se, në këtë mënyrë, po bëhet edhe një hap shumë i rëndësishëm për Kuvendin e Kosovës.

Ata që me vëmendje e ndjekin punën e Kuvendit të Kosovës, me siguri se kanë mundur të vërejnë përpjekjet tona për një varg projektesh të tjera të natyrave të ndryshme, por që e avancojnë, e rrisin efikasitetin dhe e modernizojnë procesin e punës, kurse Kuvendin e ofrojnë më afër standardeve të kuvendeve të tjera në rajon e më gjerë.

Megjithatë, ato projekte ende nuk kemi mundur t'i finalizojmë për faktin se, vazhdimisht, para nesh na kanë dalë çështje të natyrave më urgjente.

Por, ne nuk do të ndalemi. Do të ecim drejt modernizimit të të gjitha segmenteve të jetës dhe të punës së Kuvendit, ndonëse të vetëdijshëm se konsolidimi dhe strukturimi

modern i institucioneve tona është sfidë me të cilën po ballafaqohemi e do të ballafaqohemi në vazhdimësi. Dhe, në fund, më lejoni që, në përmbyllje të kësaj fjale time të shkurtër, të shpreh optimizmin tim racional se, prej sot, edhe thënien e Lorkës do ta vëmë në arkiv, për t'ua përcjellë atë edhe brezave që vijnë pas nesh. Atyre që arkivat e kokave tona do t'i bartin në institucionet tona adekuate”, u shpreh Berisha.

Në emër të projektit të UE-së “Mbështetje e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës” të pranishmit i përshëndeti **Hugues Courtivron**. Ai theksoi se ky projekt po realizohet në kuadër të ndihmës së konzorciumit të katër parlamenteve evropiane : Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Sllovenisë. Ndërkaq , tërë punën në realizimin praktik të projektit do ta bëjnë punëtorët civilë të Kuvendit të Kosovës dhe të Arkivit të Kosovës. Është ky pra edhe një shembull i mirë i ndërtimit të shtetit të Kosovës, theksoi ai.

Vlen të theksohet se Memorandumit do t' i sigurojë Kuvendit trajnime konkrete dhe profesionale për njësinë e arkivit. Memorandumit do të mundësojë zbatimin e ligjit për lëndët arkivore dhe arkivat, si dhe aktet nënligjore të dala nga ky ligj dhe ato për menaxhim zyrtar dhe arkivor. Do të ndihmohet kështu procesi i regjistrimit dhe i ruajtjes së dokumenteve në Parlamentin e Kosovës.

Ky partneriteti i ri në mes të Kuvendit të Kosovës dhe Arkivit të Kosovës është një shembull i mirë i dalë nga një bashkëpunim i shkëlqyer në mes të dy institucioneve të Kosovës, të cilat punojnë drejt ndërtimit të një shërbimi publik të qëndrueshëm dhe profesional. Shërbimi i Arkivit është njësi me rëndësi në kuadër të veprimtarisë të Parlamentit: Ruajtja e procesit legjislativ është një dëshmi afatgjate dhe autentike e të kaluarës dhe e zhvillimit të Parlamentit.

Agjenda evropiane është prioritet i institucioneve të Kosovës

- Pas përcaktimit të statusit të Kosovës të nënshkruhet marrëveshja e asocim-stabilizimit
- Kosova të ndihmohet në rrugën e saj drejt integritimeve evropiane
- Të përshpejtohet puna për miratimin e ligjeve për implementimin e statusit si dhe të mbahet kujdes që të gjitha ligjet e miratuara të jenë kompatible me legjislacionin evropian, në mënyrë që të lehtësohet rruga për në UE

Komisioni Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euro-Atlantike ka pritur sot drejtorin për Ballkanin Perëndimor në Komisionin për Zgjerim të Unionit Evropian, z. Pierre Mirel, dhe z. Christoph Stock e z. Khaldoun Sinno, nga Zyra për Kosovën në Komisionin Evropian.

Nënkryetari i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euro-Atlantike, Bajram Rexhepi, ka theksuar në takim se agjenda evropiane është prioritet i institucioneve të Kosovës dhe se për këtë synim kanë investuar të gjitha qeveritë e Kosovës, pas luftës. Aktualisht, gjithë vëmendja e kosovarëve është kthyer në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ku pritet të vendoset për statusin e Kosovës, por se pas përcaktimit të statusit të vendit tonë, duam që Kosova ta nënshkruajë marrëveshjen e asocim-stabilizimit, ka thënë Rexhepi.

Drejtori për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian për Zgjerim të Unionit Evropian, z. Pierre Mirel, ka lavdëruar përpjekjet e Kosovës drejt integritimeve evropiane, por ka theksuar gjithashtu se bashkë me agjendën evropiane shkojnë implementimi i statusit dhe ngrit-



ja e disa institucioneve dhe e kapaciteteve të nevojshme njerëzore. Ai ka thënë se Kosova duhet të ndihmohet edhe më tej, në mënyrë që, në fazën sa më të shkurtër pas statusit, t'i plotësojë kushtet e paraanëtarësimit, siç i kanë plotësuar vendet tjera, të cilat sot janë anëtare të UE-së. Mirel u ka sugjeruar parlamentarëve kosovarë që të përshpejtohet puna për miratimin e ligjeve për implementimin e statusit si dhe të mbahet kujdes që të gjitha ligjet e miratuara të jenë kompatible me legjislacionin evropian, në mënyrë që të lehtësohet rruga për në UE. Ai, ndërkaq, ka porositur që të gjitha projektligjet, të cilat kalojnë për miratim në

Kuvendin e Kosovës, të shoqërohen me koston financiare të implementimit të tyre.

Edhe nënkryetari tjetër i Komisionit për Bashkëpunim me Jashtë, Xhezair Murat, por edhe anëtarët e tjerë, Jakup Krasniqi, Teuta Sahatqija dhe Alush Gashi, kanë theksuar se Kosova nuk ka agjendë tjetër, pos asaj evropiane dhe kanë kërkuar që vendi ynë të mbështetet në rrugën e pavarësisë dhe pastaj edhe të anëtarësimit në Unionin Evropian.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar se pas përcaktimit të statusit, duhet parë mundësia e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, që duam t'i vizitojnë vendet e UE-së.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, në dy vitet e fundit, i realizoi disa projekte kapitale

Posaçërisht duhet përmendur rekonstruktimin e një pjese të pistës, rrethimi i të njëjtës me tel, zgjerimi i platformës, modifikimi i terminalit, garazhit të zjarrfikësve dhe rruga e re e asfaltit për automjete

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës, i udhëhequr nga Ibush Jonuzi, kryetar, vizitoi Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Në fillim të vizitës, në hapësirat e Drejtorisë së Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, anëtarët e Komisionit u takuan me drejtorin gjeneral z. Afrim Haziri dhe bashkëpunëtorët e tij më të afërt. Në takimin e përmendur, duke u informuar për punën e gjithëmbarshme të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, a posaçërisht drejtori Haziri theksoi se prej vitit 2004 nga KFOR-i i kanë marrë të gjitha kompetencat lidhur me menaxhimin e Aeroportit. Në vazhdim u theksua se ky Aeroport punon dhe funksionon sipas standardeve ndërkombëtare, d.m.th. sipas standardeve të IHO-së dhe se vitin e kaluar nga ana e

Organizatës Ndërkombëtare për Komunikacionin Civil, ky aeroport është shpallur si aeroport më i suksesshëm për bartjen deri në një milion udhëtarë.

Në vazhdim të mbledhjes u theksua se Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, në dy vitet e fundit, ka realizuar disa projekte kapitale, prej të cilave duhet përmendur si vijon: rekonstruktimi i një pjese të pistës, rrethimi i saj me tel, zgjerimi i platformës, modifikimi i terminalit, garazhi i zjarrfikësve dhe rruga e re me asfalt për automjete, kështu që me këto projekte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës tashmë është modernizuar dhe ofron të gjitha kushtet e domosdoshme, si për bartje të udhëtarëve, ashtu edhe në krijimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të mira për ta, pranimin e mallrave dhe shpërndarjen e tyre. Në bisedë është theksuar se gjatë vitit 2006 është bërë

edhe racionalizimi i vendeve të punës, d.m.th. prej gjithsej 631 punëtorësh në fillim të vitit, në fund të vitit ky numër u reduktua në gjithsej 571 punëtorë.

Drejtori i këtij Aeroporti, z. Haziri, përveç tjerash theksoi se ky aeroport bashkëpunon me gjithsej 17 kompani dhe se gjatë kohës së fluturimeve të sezonit të sivjetmë veror, pritet të bashkëpunojë edhe me 23 kompani të tjera. Drejtori Haziri, duke folur për problemet, përkatësisht vështirësitë, theksoi se mungesë më të madhe paraqet mos nxjerrja e Ligjit për

Komunikacionin Civil dhe moslicencimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Gjatë vizitës së këtij aeroporti, anëtarët e Komisionit vizituan edhe Prgun kryesor, Garazhin e zjarrfikësve, Zyrën për planifikim dhe Qendrën meteorologjike, që janë në përbërje të këtij aeroporti.

Gjendje e rëndë në kinematografinë kosovare

Një nga pasojat e moszbatimit të ligjit është edhe fakti që Qendra Kinematografike e Kosovës ende nuk vepron ashtu si e përcakton ligji

Kinematografia në Kosovë është në gjendje shumë të rëndë. Kjo është pasojë e faktit që nuk po zbatohet në praktik ligji për kinematografinë. Megjithëse ligji ka disa mangësi, po të zbatohet ashtu si është do të arriheshin më shumë rezultate në fushën e filmit kosovar. Këto ishin vetëm disa nga brengat e krijuesve të lëmit të kinematografisë së Kosovës në dëgjimin publik të organizuar nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit, lidhur me mënyrën e

implementimit të Ligjit për Kinematografi nr. 2003/22, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 08.07.2004, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/38, më 30 korrik 2004.

Një nga pasojat e moszbatimit të ligjit është edhe fakti që Qendra Kinematografike e Kosovës ende nuk vepron ashtu si e përcakton ligji. Ajo është Qendër vetëm në letër duke mos mundur të kryejë funksionin e vet themelor, pra të jetë promotor i zhvillimit të filmit. Në kuadër të kësaj Qendre nuk veprojnë as segmentet tjera që i parasheh

ligji. Nga krijuesit e filmit bëheshin edhe shumë vërejtje sa i përket keq menaxhimit të mjeteve me rastin e realizimit të projekteve, si dhe në mos angazhimin e Ministrisë së Kulturës për zbatimin e ligjit.

Pas këtij debati shumë të gjerë u konstatua se Komisioni do të angazhohet maksimalisht për të dalë nga kjo situatë. Në këtë vështrim u tha se shumë shpejt në një mbledhje të këtij Komisioni do të ftohen ministri i Kulturës dhe ai i Buxhetit dhe Financave për të parë se si të gjenden rrugët për të dalë nga kjo gjendje e rëndë.

Shqyrtohen zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë

- Në takim mori pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Jonuz Salihaj
- Për sundimin e ligjit, rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe përmirësimin e kushteve të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit
- Sa vjen e shtohet numri i lëndëve të papërfunduara nëpër gjykata
- Nuk mjaftojnë vetëm 421 gjyqtarë dhe prokurorë në gjykatat e Kosovës
- Kryetari i Komisionit, Hyseni, ka kërkuar lirinë e të gjithë të burgosurve pa faj, përfshirë edhe liderin e lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti

Komisioni Parlamentar për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, në drejtimin e Hydajet Hysenit, kryetar i komisionit, ka shqyrtuar sot zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë, ndërkaq në takim ka marrë edhe pjesë edhe ministri i Drejtësisë, Jonuz Salihaj, i cili i ka njoftuar anëtarët e komisionit me hapat që ka marrë dhe do t'i marrë në vazhdim Ministria e Drejtësisë për sundimin e ligjit, rritjen e efikasitetit të gjykatave, përmirësimin e kushteve të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për punën që po bëhet për miratimin e legjislacionit të nevojshëm për funksionim të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Kryetari i komisionit, Hyseni, duke e hapur takimin, ka theksuar se vendit i nevojitet një sistem bashkëkohor dhe funksional i drejtësisë, i bazuar në ndarjen dhe balancin e pushteteve. Ai ka thënë se komisioni, të cilin e udhëheq, angazhohet për depolitizimin e gjyqësorit dhe riemërimin e kuadrit gjyqësor dhe prokurorial, duke shtuar se na duhet punë e përbashkët, në mënyrë që të mos na përsëritën atavizmat e dënimeve politike në Kosovë. Ai, ndërkaq, ka tërhequr vëmendjen se nuk janë marrë parasysh sa duhet vërejtjet e komisionit pas vizitës që u ka bërë burgjeve të Kosovës.

Ministri i Drejtësisë, Jonuz Salihaj, pasi ka përkujtuar kompetencat e reja që ka marrë ministria, të cilën e udhëheq, ka folur për strukturimin e saj, si dhe për funksionalizimin dhe efikasitetin e gjyqeve në Kosovë. Ai

me këtë rast ka përmendur faktin se, megjithëkëtë, sa vjen e shtohet numri i lëndëve të papërfunduara nëpër gjykata, duke konstatuar se nuk mjaftojnë vetëm 421 gjyqtarë dhe prokurorë në gjykatat e Kosovës. Salihaj ka qenë i një mendje se nevojitet reformim i thellë i sistemit të drejtësisë, rritje e përgjegjësisë profesionale, si dhe eliminim i atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë rënë ndesh me ligjin dhe moralin.

Salihaj ka përmendur rezultatet e lavdërueshme në lëmin e shërbimit sprovues dhe atij korrektues të Kosovës dhe është angazhuar për aplikimin e dënimeve alternative.

Duke folur për hapat që po merr ministria e tij për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për sistemin e drejtësisë, ai ka përmendur Projektligjin për gjykatat, atë për Prokuroritë, Projektligjin për procedurat kontestimore, jokontestimore dhe përmbaruese, që së shpejti do të vijë në Kuvend për miratim, si dhe miratimi i Projektligjit për noterinë, i cili ka kaluar shqyrtimin e parë. Këto ligje do ta lehtësojnë shumë punën e gjykatave ka thënë ministri i Drejtësisë.

Anëtarët e komisionit kanë vlerësuar punën e ministrisë dhe janë zotuar se do ta ndihmojnë atë për sundimin e ligjit në Kosovë dhe krijimin e një sistemi bashkëkohor të drejtësisë. Kryetari i komisionit, Hydajet Hyseni, ndërkaq, në përfundim të takimit ka kërkuar lirinë e të gjithë të burgosurve pa faj, përfshirë edhe liderin e lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

HYDAJET HYSENI DHE ISMAIL KURTESHI MARRIN PJESE NË SAMITIN BOTËROR PËR PAQE UNIVERSALE, NË SEUL

Kosovës i duhet paqe e qëndrueshme

Në mesin e 300 pjesëmarrësve nga 150 vendeve të botës, në Samitin Botëror për Paqe Universale, që ka filluar punimet në Seul të Koresë, po marrin pjesë edhe dy përfaqësues nga Kosova: deputeti Hydajet Hyseni dhe ish -deputeti, Ismail Kurteshi. Në këtë samit ndërkom-bëtar, në të cilin marrin pjesë bur-rështetas, qeveritarë, parlamentarë e liderë fetare, sot është folur edhe për Kosovën.

Përfaqësuesi i Këshillit kosovar për Paqe, Hydajet Hyseni, ka folur në sesionin e samitit: Parlamentaret për paqe si dhe në grupin punues të programeve të parlamentareve për aktivitetet e ardhshme për paqen.

Pasi ka paraqitur një tablo të gjendjes së përgjithshme në Kosovë, të shkaqeve të problemit dhe zhvillimeve aktuale, ai ka theksuar rëndësinë e procesit të finalizimit të zgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe veçmas përkrahjes që i duhet Kosovës nga bota demokratike e paqedashëse. "Kosovës i duhet paqe e qëndrueshme, kurse e tille mund të jete vetëm, paqja e drejte, paqja që zgjidh problemin në përputhje me vullnetin e qytetarëve të saj", ka thënë Hyseni. Pavarësia e Kosovës, ka nënvizuar ai, nuk është zgjidhja më e mirë për shqiptarët, por është zgjidhje kompromisi, nën të cilin nuk ka fare zgjidhje. Kosova, ka spikatur parlamentar kosovar, do ta justifikojë ndihmën e dhënë, pos tjerash, edhe duke ndërtuar një të ardhme të lirë e të sigurt dhe perspektivë për të gjithë popujt dhe qytetarët që jetojnë dhe duan të jetojnë në Kosovën e Re.

Fjala e zotëri Hysenit është prituri mirë nga pjesëmarrësit e Samitit botëror për Paqen Universale, i cili i vazhdon punimet.

Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë sa më parë Ligjin për sëmundjet ngjitëse

- *Ligji do të ndihmojë shumë në luftën kundër të gjitha sëmundjeve ngjitëse, veçmas në luftën kundër epidemisë së gripit të shpezëve*
- *Në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë të themelohet Fondi rezervë për fatkeqësitë natyrore, përfshirë këtu edhe epidemitë e ndryshme*

Tash për tash në tërë territorin e Kosovës nuk ka dukuri të shfaqjes së epidemisë së gripit të shpezëve, mirëpo që nga tani duhet të përgatitemi sikur e njëjta të shfaqet që nga nesër në tërë territorin e Kosovës. Është ky konstatim kryesor i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës, nga mbledhja që e kryesoi z.-nja Fatmire Mullhaxha –Kollçaku, kryetare e Komisionit, në të cilën pikë kryesore e rendit të ditës ishte informata lidhur me përgatitjet e planit të dytë me radhë nga Instituti i Shëndet Publik të Kosovës, në lidhje me luftën kundër epidemisë së gripit të shpezëve në territorin e Kosovës, që është përgatitur në bashkëpunim me ekspertin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, z. Claude de Vile de Goyet.

Në mbledhjen në fjalë, përveç anëtarëve të Komisionit, morën pjesë edhe drejtori i Institutit të Shëndetit Publik të Kosovës, dr. Naser

Ramadani, si dhe përfaqësuesi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë – Zyra në Kosovë, z. Sami Uka.

Në mbledhjen e theksuar, duke folur për epideminë e grupit të shpesëve, z. Wile de Goyet theksoi që Organizata Botërore e Shëndetësisë, epideminë e grupit të shpezëve e ka ndarë në gjashtë faza dhe se, në momentin aktual, në botë është e njohur faza e tretë, përkatësisht bartja e epidemisë së gripit nga zogjtë tek njerëzit, por se duhet të përgatitemi edhe për fazën e gjashtë, do të thotë për fazën e bartjes së kësaj sëmundjeje të rrezikshme nga njeriu në njeri. Në diskutimin e mëtejshëm, z. Goyet theksoi që duke marrë parasysh fazën prej të katërtës deri në fazën e gjashtë, ata që janë të infektuar nga kjo sëmundje e rrezikshme, mund ta humbin jetën, numër ky që sillet prej 600 deri në 12.000 njerëz. Duke qenë se tash për tash nuk ka vaksinë adekuate kundër gripit të shpezëve, metoda më e mirë e për-

gatitjes për sëmundjen e rrezikshme të lartë theksuar është furnizimi me sasi të mjaftueshme të antibiotikëve, të aparateve respiratorë, me dorëza dhe maska sterile dhe me barna të tjera adekuate. Po ashtu, duhet të punohet edhe në atë drejtim që popullata të informohet me kohë dhe në mënyrën e duhur lidhur me këtë sëmundje fatale dhe me preventivën e epidemisë së saj.

Në mbledhjen e këtij komisioni, lidhur me rendin e ditës, ndër të tjera, u theksua që Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë sa më parë Ligjin për Sëmundjet Ngjitëse, i cili në sferën e legjisllacionit do të ndihmojë mjaftë në luftën kundër të gjitha sëmundjeve ngjitëse, veçmas në luftën kundër epidemisë së gripit të shpezëve, si dhe që në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë të themelohet Fondi i veçantë rezervë për fatkeqësitë natyrore, përfshirë këtu edhe epidemitë e ndryshme.

Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat edhe më tutje ngre dilema para anëtarëve të Komisionit

Me gjithë se Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat ka kaluar qysh moti në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, madje për këtë Projektligj janë organizuar edhe dy dëgjime publike, anëtarët e Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport i Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit, kishte sot edhe një shqyrtim lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat. Ata ende gjenden para dilemave se a duhet një lëmë i këtillë të rregullohet me ligj të veçantë

apo në kuadër të ligjeve ekzistuese nga fusha e arsimit të bëhen amendamente, me të cilat do të rregullohet edhe çështja e arsimit dhe aftësimin privat. Gjatë debatit u tha se është e nevojshme të rregullohet çështja e arsimit dhe aftësimin privat, sepse është evidente se aty ka parregullsi, mirëpo çështje është se athua ky Projektligj jep zgjidhje adekuate për tejkalimin këtyre parregullsive. Konstatohet edhe se Projektligji nuk përmban standarde përkatëse nga ky lëmë. Në këtë vështrim anëtarët e Komisionit shtron-

in çështjen: a duhet të vazhdojë puna për plotësimin e mirëfilltë të këtij Projektligji apo ky Projektligj duhet t'i kthehet sërish sponsoruesit, përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë. Shih për këtë ata në këtë mbledhje kishin ftuar edhe ministrin e kësaj ministrie, Agim Velin, por ai nuk kishte ardhur. Në këtë situatë ata vendosën që të thërrasin edhe një here ministrin që së bashku të vendosin për këtë çështje, në të kundërtën ata do të propozojnë që Projektligji t'i kthehet sponsoruesit.

Evidenca e Ligjeve

vijon nga numri i kaluar

Legjislatura II (2004-2007) - Evidenca e Ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2005	Qeveria e Kosovës	02/L-13	23.02.2005	Si Rregullore e UNMIK-ut 2005/12 01.03.2005
2.	Ligji për plot. e ndrysh.të ligjit 2003/2, për menaxh.fincancave publike	-/-	02/L-16	23.02.2005	2005/27 17.05.2005
3.	Ligji për verërat	-/-	02/L-8	23.02.2005	2005/47 14.10.2005
4.	Ligji për lirimë e asociimit në OJQ-të	-/-	02/L-6	23.02.2005	
5.	Ligji për inspektionin e tregut	-/-	02/L-1	23.03.2005	2005/29 31.05.2005
6.	Ligji për mbështetje ndërmarrjeve të vogla e të mesme	-/-	02/L-5	23.03.2005	2005/44 08.09.2005
7.	Ligji për ujtimen e tokës bujqësore	-/-	02/L-9	23.03.2005	2005/49 25.11.2005
8.	Ligji për kujdesjen ndaj kafshëve	-/-	02/L-10	23.03.2005	2005/24 09.05.2005
9.	Ligji për teatrin	-/-	02/L-12	23.03.2005	2005/31 08.06.2005
10.	Ligji për produktet e ndërtimit	-/-	02/L-14	23.03.2005	2005/28 17.05.2005
11.	Ligji për mbrojtjen e natyrës	-/-	02/L-18	23.03.2005	2006/22 24.04.2006
12.	Ligji për komisionin e pavarur të mediave	-/-	02/L-15	21.04.2005	2005/34 08.07.2005
13.	Ligji për shërbimet sociale dhe familjare	-/-	02/L-17	21.04.2005	2005/46 14.10.2005
14.	Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve	-/-	02/L-21	20.05.2005	
15.	Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit	-/-	02/L-20	24.06.2005	2005/36 21.07.2005
16.	Ligji për tokat bujqësore	-/-	02/L-26	24.06.2005	2006/37 23.06.2006
17.	Ligji për shërbimet e shoqërisë informative	-/-	02/L-23	22.07.2005	2006/32 08.05.2006
18.	Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur	-/-	02/L-24	22.07.2005	2005/43 07.09.2005
19.	Ligji për procedurën administrative	-/-	02/L-28	22.07.2005	2006/33 13.05.2006
20.	Ligji për mbeturina	-/-	02/L-30	22.07.2005	2006/31 05.05.2006
21.	Ligji për duhanin	-/-	02/L-36	03.10.2005	2007/1 09.01.2007
22.	Ligji për procedurën e dhënjes së Koncesioneve	Kuvendi i Kosovës	02/L-44	03.10.2005	2006/27 27.04.2006
23.	Ligji për ngrohjen qendrore	-/-	02/L-49	03.10.2005	
24.	Ligji për investimet e huaja	Qeveria e Kosovës	02/L-33	21.11.2005	2006/28 28.04.2006
25.	Ligji për akreditimin	-/-	02/L-43	21.11.2005	2006/15 21.04.2006
26.	Ligji për dizajimin industrial	-/-	02/L-45	21.11.2005	2006/17 21.04.2006
Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP

27	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2006		Qeveria e Kosovës	02/L-61	19.12.2005	Si Rregullore e UNMIK-ut 2005/55 20.12.2005
28	Ligji për gjuetinë		-/-	02/L-53	16.12.2005	2006/41 11.08.2006
29	Ligji për metrologji		-/-	02/L-34	19.01.2006	2006/18 22.04.2006
30	Ligji për Inspektoratin shëndetësor		-/-	02/L-38	19.01.2006	2006/13 23.03.2006
31	Ligji për edukimin parashkollor		-/-	02/L-52	19.01.2006	2006/11 06.03.2006
32	Ligji për minierat dhe mineralët		-/-	02/L-55	19.01.2006	
33	Ligji për provimin e jurisprudencës		-/-	02/L-40	20.01.2006	2006/30 02.05.2006
34	Ligji për RTK-në		-/-	02/L-47	20.01.2006	2006/14 11.04.2006
35	Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës		-/-	02/L-2	23.02.2006	
36	Ligji për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës		-/-	02/L-25	23.02.2006	2006/23 24.04.2006
37	Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional		-/-	02/L-42	23.02.2006	2006/24 25.04.2006
38	Ligji për kujdesin shëndetësor emergjent		-/-	02/L-50	23.02.2006	2006/21 22.04.2006
39	Ligji për markat tregtare		-/-	02/L-54	23.02.2006	2006/38 28.06.2006
40	Ligji për veprimtarinë botuese dhe librin		-/-	02/L-51	16.03.2006	2006/16 21.04.2006
41	Ligji për konfliktet administrative		-/-	02/L-64	16.03.2006	
42	Ligji për mbrojtjen nga zjarri		-/-	02/L-41	06.04.2006	2006/57 20.12.2006
43	Ligji për institucionet e kulturës		-/-	02/L-57	06.04.2006	2006/44 18.08.2006
44	Ligji për inspektoratin e produkteve të ndërtimit		-/-	02/L-62	06.04.2006	2006/39 11.08.2006
45	Ligji për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës		-/-	02/L-59	01.06.2006	2006/42 12.08.2006
46	Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera		-/-	02/L-68	01.06.2006	2007/4 15.01.2007
47	Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjës		-/-	02/L-65	15.06.2006	2007/13 28.02.2007
48	Ligji për veprimtarinë Hidrometeorologjike		-/-	02/L-79	15.06.2006	2007/2 09.01.2007
49	Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit Pedagogjik		-/-	02/L-67	29.06.2006	2006/45 18.08.2006
50	Ligji për lirinë fetare në Kosovë		-/-	02/L-31	13.07.2006	2006/48 24.08.2006
51	Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë		-/-	02/L-73	13.07.2006	
52	Ligji për plot. e ndrysh. të Ligjit 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat		Kuvendi i Kosovës	02/L-80	13.07.2006	2006/40 11.08.2006
53	Ligji për plotësimin e ndryshim të Ligjit 2004/12 për Standardizim		Qeveria e Kosovës	02/L-83	13.07.2006	2006/43 14.08.2006
54	Ligji për përdorimin e gjuhëve		-/-	02/L-37	27.07.2006	2006/51 20.10.2006
55	Ligji për trashëgiminë kulturore		-/-	02/L-88	09.10.2006	2006/52 06.11.2006
56	Ligji për shëndetin riprodhues		-/-	02/L-76	10.10.2006	2007/11 07.02.2007
57	Ligji për hulumtime gjeologjike		-/-	02/L-82	10.10.2006	

58	Ligji për peshkatari dhe Akuakulturë	-/-	02/L-85	10.10.2006	2006/58	20.12.2006
59	Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2004/5 për naftë dhe derivatet e naftës	-/-	02/L-89	10.10.2006		
60	Ligji për Auditimin e Brendshëm	-/-	02/L-74	16.11.2006		
Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP	
61	Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2004/49 për Patentim	Qeveria e Kosovës	02/L-100	18.12.2006		
62	Ligji për pajisjet nën presion	-/-	02/L-103	18.12.2006	2007/5	31.01.2007
63	Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri	-/-	02/L-81	22.12.2006		
64	Ligji për mbrojtjen e bimëve	-/-	02/L-95	22.12.2006	2007/6	31.01.2007
65	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2007	-/-	02/L-112	23.12.2006	Si Rregullore e UNMIK-ut 2006/61 28.12.2006	
66	Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor	-/-	02/L-70	11.01.2007		
67	Ligji për Arbitrazhin	-/-	02/L-75	26.01.2007		
68	Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2003/25 për Kadastrën	-/-	02/L-96	26.01.2007		
69	Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve	-/-	02/L-98	26.01.2007		
70	Ligji për raportimin financiar të ndërmarrjeve	-/-	02/L-84	08.02.2007		
71	Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2003/17 për prokurimin publik	-/-	02/L-99	08.02.2007		
72	Ligji për shpronësimet	Kuvendi i Kosovës	02/L-97	08.02.2007		
73	Ligji për sigurimet shëndetësore	Qeveria e Kosovës	02/L-07	22.02.2007		
74	Ligji për shëndetësinë publike	-/-	02/L-78	22.02.2007		
75	Ligji për mbrojtjen nga zhurma	-/-	02/L-102	30.03.2007		
76	Ligji për bletari	-/-	02/L-111	30.03.2007		
77	Ligji për Numrin Personal	-/-	02/L-117	13.04.2007		
78	Ligji për Emrin Personal	-/-	02/L-118	13.04.2007		
79	Ligji për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut, dhe produkteve të tij	-/-	02/L-101	13.04.2007		

P/ligjet të cilat janë në procedurë

Nr	Emërtimi i Projektligjit	Propozuesi	Data e pranimit		Dt. shpërndarjes Deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi mi dytë
1	P/Ligji për prokurorinë publike	Qeveria e Kosovës	28.12.2004	28.12.2004	29.12.2004	26.01.2005	
2	P/Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve	-/-	29.12.2004	29.12.2004	29.12.2004	26.01.2005	

3	P/Ligji për taksat gjyqësore	-/-	21.03.2005	21.03.2005	shtyhet
4	P/Ligji për mjekësinë ligjore	-/-	16.05.2005	17.05.2005	shtyhet
5	P/Ligji për grevat	-/-	31.05.2005	31.05.2005	24.06.2005
6	P/Ligji për ushqimin	-/-	14.09.2005	15.09.2005	21.11.2005
7	P/Ligji për arsimin dhe aftësimin privat	-/-	28.10.2005	28.10.2005	19.12.2005
8	P/Ligji për drejtat dhe liritë e organizimit sindikal	-/-	31.10.2005	31.10.2005	19.12.2005
9	P/Ligji për ndërmjetësimin	-/-	02.12.2005	02.12.2005	20.01.2006
10	P/Ligji për ditën e dëshmorëve	-/-	19.12.2005	20.12.2005	20.01.2006
11	P/Ligji për eficientën e energjisë	-/-	27.01.2006	27.01.2006	16.03.2006
12	P/Ligji për parandalimin e pastrimit të parave	-/-	14.02.2006	15.02.2006	16.03.2006
13	P/Ligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore	-/-	07.04.2006	10.04.2006	11.05.2006
14	P/Ligji për zonat e lira Industriale	-/-	05.07.2006	06.07.2006	shtyhet
15	P/Ligji për parqet nacionale	-/-	05.07.2006	06.07.2006	27.07.2006
16	P/Ligji për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës	-/-	27.07.2006	31.07.2006	31.08.2006
17	P/Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2004/9 për Rregullatorin e energjisë	Qeveria e Kosovës	28.07.2006	31.07.2006	31.08.2006
18	P/Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2004/8 për Energji	-/-	28.07.2006	31.07.2006	31.08.2006
19	P/Ligji për TVSH-në	-/-	28.09.2006	29.09.2006	20.10.2006
20	P/Ligji për Noterinë	-/-	18.10.2006	18.10.2006	16.11.2006
21	P/Ligji për punën	-/-	19.10.2006	19.10.2006	16.11.2006
22	P/Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse	-/-	30.10.2006	31.10.2006	22.12.2006
24	P/Ligji për ndihmën shtetërore	-/-	10.11.2006	13.11.2006	14.12.2006
25	P/Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje	-/-	15.11.2006	15.11.2006	14.12.2006
26	P/Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2002/9 për Inspektoratin e Punës	-/-	24.11.2006	24.11.2006	22.12.2006
27	P/Ligji për plotësim e ndryshim të Ligjit 2003/4 për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik	-/-	27.11.2006	29.11.2006	22.12.2006
28	P/Ligji për kimikate	-/-	11.12.2006	13.12.2006	11.01.2007
29	P/Ligji për Letërnjoftimin	-/-	31.01.2007	31.01.2007	22.02.2007
30	P/Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi planifikimin hapësinorë	-/-	16.02.2007	19.02.2007	16.03.2007
31	P/Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin	-/-	23.02.2007	26.02.2007	16.03.2007
32	P/Ligji për bujqësinë organike	-/-	16.03.2007	19.03.2007	13.04.2007
33	P/Ligji shoqëritë tregtare	-/-	16.04.2007	17.04.2007	



Takimi Ber'isha - Papa Benedikti XVI